

Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-92766/26 dt. 25.06.2026 (përmes e_Leja KKN-01085), në emër të aplikuesit Besart Halilaj nga Glligoci, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin 2 shtëpive të banimit, në kuadër të bllokut urban “L-48” të tërësisë hapësinore “L” të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 254-4 dhe 254-5 ZK Çagllavicë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 16.07.2026 deri më 20.07.2026, në e-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesë-shtëpi banimi, me etazhitet B+P+1
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	5.00 m'
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~7.50 m'/5.00 m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	7.50 m'/3.00 m' 7.50 m'/1.50m' 7.50 m'/2.20 m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=40 %=120 m ² , e propozuar 120 m ²
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40 %=120 m ² , e propozuar ~180.00 m ²
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=max. 450 m ² , e propozuar 240 m ²
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=60 %=180 m ² , e propozuar 140 m ²
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	3 vendparkime të brendshme
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	/
m. A ka qasje te pakufizuar ne rruge publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
n. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona për rreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari

